

KËRKESË
Nr.6417/5, datë 10.12.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Lidhja e rrugës hyrëse Kombinat me Urën e re Berat”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë se kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit truall dhe objekte.

Pronarët për të cilët në kolonën “shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Ndërsa në kolonën e objekteve është bërë shënimi “proces legalizimi”. Këta persona do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të jetë kryer legalizimi nga institucionet përkatëse.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 22 930 476 (njëzet e dy milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E TROJEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“LIDHJA E RRUGËS HYRËSE KOMBINAT ME URËN E RE BERAT”

		PRONARI			NR.		TOKË TRUALL		VLERA	
NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	ZK	PAS.	SIP.M ²	ÇMIMI LEKË/M ²	VLERA LEKË	TOTALE LEKË	SHËNIME
1	FITIME		MOLISHTI	8501	10/263	550	3100	1705000	1705000	KONF ZRPP
2	B/PRONARËT		DRENOVA	8501	10/189	1041	3100	3227100	3227100	KONF ZRPP
3	B/PRONARËT		DRENOVA	8501	10/185	143	3100	443300	443300	KONF ZRPP
4	KAMBER		HASANI	8501	9/194	140	3100	434000	434000	KONF ZRPP
		SHUMA				1874		5809400	5809400	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“HYRJE-BERAT”

NR.	EMRI	PRONARI	MBIEMRI	ZK	NR.PAS.	VLERA	SHËNIME
		ATËSIA				TOTALE LEKË	
1	KAMBER		HASANI	8501	9/194	661 1687	KONF ZRPP
2	SHPËTIM		ZANAJ	8501	10/35	1097745	KONF ZRPP
3	LULZIM		BALLA	8501	11/13	577350	KONF ZRPP
4	KLEI	EDISON	ÇOBO	8501		3444659	NË PROCES LEGALIZIMI
5	ALI		HASANI	8501		2166724	NË PROCES LEGALIZIMI
6	RUSHIT		AZIZI	8501		1327105	NË PROCES LEGALIZIMI
7	YLMI		DUSHKU	8501		324536	NË PROCES LEGALIZIMI
8	ROBERT		ÇELA	8501		1571270	NË PROCES LEGALIZIMI
	SHUMA					17121076	